

Dane Taleski

DIALOGU POLITIK NË MAQEDONI PAS MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT

Dane Taleski
Doktor i Shkencave Politike
Universiteti i Europës Qendrore
Nador u.. 9, 1052 Budapest

Pse është e rëndësishme Marrëveshja Kornizë e Ohrit për atë se e a ka ose nuk ka dialog politik në Maqedoni? Shumë thjeshtë. Për shkak se implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ka sjellur ndryshime rrënjësore në sistemin politik dhe praktikën politike, e për të ta kuptuar politikën e sotme në Maqedoni duhet ti dijmë pasojat dhe efektet që dalin nga implementimi i saj. Por në Maqedoni mungojnë analiza dhe diskutime për pasojat dhe efektet nga implementimi i Marrëveshjes Kornizë.

Para se të fillojë implementimi i Marrëveshjes Kornizë u zhvillua debat i ashpër i cili në përgjithsi negativisht figuronte karakterin e Marrëveshjes Kornizë, veçanërisht përmbajtjen e saj dhe efektin të cilën do ta ketë në sistemin politik në Maqedoni.

Vlerësimet çonin drejt asaj se stabiliteti politik dhe efikasiteti nuk do të përmirsohen me implementimin e saj, madje dukshëm do të ndërrohet karakteri i shtetit. Qëllimi kryesor ishte se Maqedonia përgjithmon e largon demokracinë parlamentare. Kuptohet këto ishin parashikime teorike dhe hipoteza, për shkak se për vlerësim të drejtë të implementimit nevojiten masa empirike ose vlerësime të asaj që ndodh në praktikë.

Parashikimet e caktuara teorike u treguan të sakta, por vetëm në shikim të parë. Demokracia parlamentare nënkupton sistem politik ku shumica vendos, por parakushti kryesor për atë është fragmentalizmi i shoqërisë të jetë dominues- një dimensional (te sundojnë dallimë politike mes të majtës dhe të djathtës). Demokracia parlamentare e shumicës është sistem i mirë për shoqëri më pak heterogjene ku në Parlamentin janë të përfaqësuar disa parti politike, nga të cilat një numër i vogël kanë shumicën dhe formojnë qeverinë e cila është relativisht kompakte

Në Maqedoni 35% i qytetarëve ju takojnë bashkësive etnike të pakicës nga të cilat pjesa dominuese janë Shqiptarët. Pas zgjedhjeve të 2008 në Parlament ka 17 deputet, ndërsa në

nivel të ministrive në qeveri janë paraqitur 4 parti, por edhe më shumë në strukturat më të ulta të pushtetit.

Përveç fragmentalizimit të shoqërisë në Maqedoni është dominiuese edhe –dy dimenzionaliteti (të rëndësishme janë dallimet politike dhe etnike). Nëse mirren parasysh fragmentalizmi i shoqërisë në Maqedoni atëherë mund të përfundohet se Maqedonia natyrisht nuk graviton kah sistemi i demokracisë parlamentare por është i nevojshëm sistem politik që do të pranojë dhe menaxhojë sistemet dy –dimensionale. Sistemet politike të tilla kanë të bëjnë me principet e demokracisë konsenzuale ose konsociale ku shumicë e cila vendos reflekton më shumë dallimet dimensionale të cilat sundojnë në shoqërinë. Demokracia parlamentare garanton efikasitet por në shoqëritë të fragmentuara demokracia konsenzuale është e nevojshme për ruajtjen e stabilitetit.

Stabiliteti është kusht i patjetërsueshëm për efikasitetet. Nëse në demokracinë konsenzuale insistohet në efikasitetet mund të fitohet parodi në demokracinë, për shembull sjelljen e 100 ligjeve Brenda disa ditëve .

Aq për teorinë , e tash të kalojmë në analizë të efekteve nga implementimi i Marrëveshjes Kornizë. Marrëveshja Kornizë në mënyrë kualitative e përmirsoi kornizën demokratike në shtet:

1. i përforcoi mundësitë për përfshirjen e pakicave (nëpërmjet definicionit të ri kushtetues në Maqedoni dhe principit të përfaqsimin të drejtë),
2. e përforcoi mbrojtjen e të drejtave të pakicave (nëpërmjet ligjeve për gjuhë, simbole, mekanizmit të shumicës së dyfishtë gjatë votimit e ashtuqujtura, shumica e Badinterit si dhe nëpërmjet procesit të Decentralizimit), dhe
3. krijoi institucione të reja nëpërmjet të cilave në të ardhmen duhet të menaxhohen marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni (Komiteti për Marrëdhënie ndëretnike).

Që do të thotë, është objektive të thuhet se Marrëveshja Kornizë, e definonte Maqedoninë si demokraci konsenzuale por gjithashtu edhe është objektive të përmendet se paradigma e demokracisë parlamentare është më e përafërt me realitetin e Maqedonisë.

Nëse pranohet rëndësia e vetëm njëres nga dimensionet e dallimeve (p.sh. ajo politikja para etnikes), ashtu siç e bën demokracia parlamentare, atëherë do të ritet polarizimi i marrëdhënieve në dimenzion tjetër të dallimeve.

Këtu dua të potencojë se polarizimet e dallimeve ndëretnike nuk mund të tejkolohen në kohë të përhershme ose nuk mund të asgjësohen . Por hulumtimet e shumta empirike tregojnë se në kuadër të një regjimi demokratik, mund të ndërtohen institucione të qëndrueshme dhe stabile për menaxhimin e dallimeve me qëllim të sigurimit të zhvillimit dhe stabilitetit. Dhe kjo është qëllimi i Marrëveshjes Kornizë, të ndërtohen institucione të tilla të cilat janë të domosdoshme në Maqedoni.

Me vetë atë nevojë duhet të jemi të vetëdijshëm se Republika e Maqedonisë nuk është dhe nuk do të jetë demokraci parlamentare por do të zhvillohet lloj tjetër i demokracisë respektivisht konsociale ose konsensuale. Demokracia konsociale nuk është e njëjtë me konsensualen. Dallimi midis tyre është kyç për tu kuptuar se si implementoheshte Marrëveshja Kornizë, nëpërmjet procesit i cili i zvogloi tensionet ndëretnike por edhe të kuptohet pse sot në Maqedoni kemi shkallë të lartë tension politik ndërpartiak.

Tejkalimi i krizës së 2001 dhe implementimi i Marrëveshjes Kornizë realizoheshte nëpërmjet sistemit të takimeve të liderëve, e cila është institucion klasik i demokracisë konsociale. Ai institucion është i rëndësishëm kur në shoqëri egzistojnë disa segmente të ndryshme dhe të rëndishme p.sh. 3 ose më shumë bashkësi etnike ; të cilat janë me segmente të rëndësishme dhe të ndryshme dhe et cilat janë me madhësi përafërsisht të njëjtë. Liderët janë përfaqësues të bashkësive etnike, ata kanë forcë politike më të madhe në krahasim me institucionet tjera, ato sjellin vendimet më të rëndësishme politike, por ata janë edhe sistemi i menaxhimit të dallimeve etnike. Nga ana tjetër, Marrëveshja Kornizë në Maqedoni sjelli institucione të demokracisë konsensuale, që do të thotë se fuqia është e disperzuar dhe e kufizuar në kuadër të sistemit (në nivel lokal, Kuvend dhe Qeveri), e për menaxhimin e dallimeve ndëretnike ka institucione të posaçme në Kuvend.

Domethënë në Maqedoni kemi procese paralele politike të demokracisë konsociale dhe konsensuale. Çfarë do të thotë kjo ? Takimet e liderëve u bënë në institucion qendror politik, ndërsa ndryshimet e institucioneve politike të parapara me Marrëveshjen Kornizë janë në radhë të dytë. Liderët të cilët marrin pjesë në takimet kanë fuqi të vendimarrjes, por takimet e tilla nuk kanë forum për tejklaumin e dallimeve etnike, por platformë për

harmonizim të zgjidhjeve politike. Përse është kjo e rëndësishme ? Kur bëhet fjalë për situatë krize, nevoja për tejkalimin e dallimeve deridiku i bën liderët të barabartë,

5

por më shumë i sjell drejt kërkesës të zgjigjjes së përbashkët. Por kur nuk keni krizë ndëretnike, siç është sot në Maqedoni, në një situatë normale liderët janë të barabartë sipas fuqisë së tyre politike dhe procesi bëhet negociim mes palëve më të forta dhe më të dobta politike. Thënë më thjeshtë, në takimet e liderëve marrin pjesë katër parti nga të cilat dy janë në koalicion, kanë shumicë të theksuar në Parlament dhe e përbëjnë Qeverinë ndërsa dy të tjerat janë opozitë në Parlament.

Pasi që liderët i sjellin vendimet ajo shkon në verifikim formal para Parlamentit, por aktorët në Parlament dhe mekanizmat janë të hendikepuar për intervenimet politike për shkak se vendimi politik është marrë nga një nivel më i lartë (si për shembull me ndryshimet e fundit të kodit zgjedhor). Në këtë mënyrë fuqia politike e vendosjes është joproportionalisht e koncentruar në liderët politik. Ky rreth magjik e imponon këtë hipotezë: nëse kontrolloni shumicë të madhe në Parlament më pak do të bashkëpunoni me opozitën në kuadër të takimeve të liderëve. Dhe e kundërt, nëse nuk keni shumicë të madhe, më shumë do të bashkëpunoni me opozitën nëpërmjet takimeve të liderëve. Domethënë momenti i vendimarrjes dhe harmonizimit të qëndrimeve politike janë jashtë standardeve institucionale të sistemit. Parlamenti nuk është trup i deliberimit, por referencë e fuqisë politike të liderëve në kuadër të takimeve të tyre. Në këtë mënyrë nuk përdoret për tejkalimin e dallimeve dhe përfshirjes të mendimeve të ndryshme, por është indikator i mbiforcës politike dhe polarizimit. Në këtë kontekst takimet e liderëve në Maqedoni të cilat ishin instrument i mirë për tejkalimin e dallimeve etnike, sot janë katalizator të politikës së polarizuar. Këtu duhet të potencojë se ndikim të rëndësishëm ka niveli dhe kultura politike të palëve në proces.

Le të sumojë pikëpamjet e mijë, Marrëveshja Konrize ishte implementuar gjatë modelit të takimeve mes liderëve (demokracia konsociale) për ta ndërtuar strukturën e re demokratike të sistemit politik në Maqedoni (demokracia konsociale).

Takimet e liderëve mund dhe duhet të shërbejnë si instrument korektues në raste krize, por gjatë kushteve normale duhet të zhvillohen institucione të demokracisë konsociale në Maqedoni.

6

Gjatë kushteve normale takimet e liderëve i favorizojnë liderët e partive të cilët kanë shumicë në Parlament, dhe e derogojnë procedurën Parlamentare. Takimet e liderëve sot e përforcojnë logjikën e fuqisë të shumicës. Interaksioni politik midis partive në Parlament krijon tensione, gjatë kohës së interaksionit të tyre partitë llogariten si armiq ku më të fuqishmit kanë motivin për të dominuar më të dobtit.

Parlamenti i Maqedonisë nuk dallon shumë me këtë nga disa vende tjera ne botë . Dallimi qëndron aty se pajtimi mes partive dhe sjellja e vendimeve të rëndësishme politike (shpriti i konsensusit) realizohet nëpërmjet takimeve të liderëve.

Shumica në Parlament është referencë e fuqisë liderëve politik.

Një numër i madh i procedurave dhe instrumenteve të cilat burojnë nga implementimi i Marrëveshjes Kornizë ende skan fituar rastin për zhivillim të praktikës të demokratike në Maqedoni. Praktika e re demokratike do të ishte tolerancë dhe respektimi i dallimeve, përfshirje më e madhe në procesin e sjelljes të vendimeve, shkallë më e lartë e deliberizimit ndërmjet palëve në interes, dhe përforcim të mekanizmave të institucionalizuara për menaxhamin e dallimeve ndëretnike.

Për tu zhvilluar demokracia konsensuale në Maqedoni duhet të jetë e qartë se shumica nuk do të thotë fuqi dhe mbifuqi por përgjegjsi dhe përkushtueshmëri. Kjo është ndoshta efekti më i rëndësishëm për politikën në Maqedoni pas implementimit të Marrëveshjes Kornizë. Nëse shumica e cila del nga dallimet dy-dimesionale (politike dhe etnike) në Maqedoni interpretohet si fuqi dhe shfrytëzohet për dominim politik, atëherë në Maqedonido të ketë më shumë konflikte politike se sa zgjidhje politike.

Implementimi i Marrëveshjes Kornizë është gati kah fundi por ajo nuk e çon drejt pikës përfundimtare. Përkundrazi, tash shtrohet nevoja për ti përforcuar institucionet e demokracisë konsensuale në Maqedon. Në këtë kuptim nuk kemi destinacion final. Duhet ti analizojmë dhe në mënyrë kritike ti vrojtojmë proceset politike dhe të mësojmë mësimin të cilat do të na ndrihojnë në të ardhmen. Duhet të jemi të vetëdijshëm se stabiliteti është nevoja më qenësore për Maqedoninë, se politika në Maqedoni duhet të jetë toleruese ndaj dallimeve ndëretnike dhe politike, se Maqedonia duhet të zhvillojë politike inkluzive dhe konsensuale.